

ABSTRAKT:

E drejta e pronësisë është instituti juridik më i rëndësishëm i së drejtës civile, në përgjithësi, dhe instituti juridik më i rëndësishëm i së drejtës sendore, në veçanti.

Në të drejtën pozitive, njihet e drejta e pronësisë me më shumë subjekte dhe ajo paraqitet në formë të bashkëpronësisë dhe pronësisë së përbashkët.

Pra, përveç rasteve kur një person e ka të drejtën e pronësisë mbi një send, ndodh që disa persona të kenë të drejtën e pronësisë mbi të njëjtin send. Nga kjo buron bashkëpronësia dhe pronësia e përbashkët. Bashkëpronësia dhe pronësia e përbashkët nuk janë lloj i veçantë i pronësisë, por formë e ekzistencës bashkërisht të shumë subjekteve të së drejtës së pronësisë mbi sendin.

Tek pronësia e përbashkët është e rëndësishme të njihet kontributi i individëve në krijimin dhe zhvillimin e pronësisë së përbashkët si dhe të përcaktohet mënyrat e pjestimit të pronësisë së përbashkët nëpërmjet një vlerësimi objektiv të kontributit të secilit person.

Fjalët kyçe: pronësia, bashkëpronësia, pronësia e përbashkët, pasuria e përbashkët, ligji.